

VENDIM
Nr.104, datë 4.9.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E RREGULLORES PËR
PROCEDURAT E LICENCIMIT**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 14 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18, pika 1, germa “g”, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.9.2008, pasi u njoh me propozimin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për rishikimin e rregullores për procedurat e licencimit,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e rregullores për procedurat e licencimit në aktivitetet e sektorit të energjisë elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për ndjekjen e procedurave ligjore për miratimin e këtyre akteve.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepavishta